



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1484/ 5 prot.

Datë 03.07.2023

V E N D I M

Nr.550/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.07.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Genius” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71354-06-01-2023 me objekt “Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi për laboratorin për aparatën Maglum 800 / ose ekuivalent i tij”, me fond limit 8,532,900.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Genius” SHPK
*Tirane Kavaje Lagjja Nr.3, Rruga Jurgen Trade,
Laboratori përballë ish Spitalit*

Autoriteti Kontraktor: Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1
Rr. “Vllazen Huta”, Tirane

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Swissmed” SHPK
*Njësia Bashkiake nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa
92, seksioni 4, Hyrja 28, Kodi Postar 1026, zona
kadastrale Nr.8310 Tirane*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë me numër ankimi elektronik A/2023/3209 datë 27.06.2023 pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe në formë shkresore pranë KPP me datë 30.06.2023 me nr. 1484/3 prot.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.06.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71354-06-01-2023 me objekt “Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi për laboratorin për aparatën Maglum 800 / ose ekuivalent i tij”, me fond limit 8,532,900.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 20.06.2023 është zhvilluar procedura prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit të tij si më poshtë vijon:

Arsyeja e skualifikimit:

Po kështu autoriteti kontraktor ka publikuar që arsyeja e skualifikimit tonë është që oferta nuk është plotësuar por çdo dokument i kërkuar në DST është paraqitur dhe hedhur nga ne në sistem dhe njëkohësisht formulari i ofertës ka qenë i rregull dhe është dorëzuar.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 27.06.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3209 dhe me nr. 1484/2023 prot., datë 27.06.2023 e operatorit ekonomik “Genius” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit si dhe kundërshtohet kualifikimi i operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK në këtë procedurë.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1484/2 date 29.06.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Genius” SHPK për të cilat ngrihen pretendime dhe kriteret, të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Me datë 30.06.2023 operatori ekonomik ankimues “Genius” SHPK ka paraqitur të njëjtën ankesë në formë shkresore në KPP e cila u protokollua me tonën me nr. 1484/3 prot.

II.7. Me shkresën nr. 470 prot, datë 29.06.2023 me objekt: “Njoftim në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Genius” protokolluar me tonën me nr. 1484/4 datë 30.06.2023 datë është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Genius” SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit ka argumentuar se: “Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave është bërë klasifikimi paraprak dhe janë njoftuar nëpërmjet sistemit të APP-se operatorët ekonomik të renditur të parë të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve nr.1 me adresë: Rr. “Vllazen Huta”, Tiranë, dokumentet provuese për vetdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike si dhe listen e dokumentacionit të paraqitur.

Pra, nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është bërë akoma njoftimi i fituesit paraprak nëpërmjet sistemit elektronik.”

II.8. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se akoma nuk është publikuar njoftimi i fituesit paraprak apo njoftimi i anulimit të procedurës së prokurimit në SPE.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 02.06.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71354-06-01-2023 me objekt “Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi për laboratorin për aparatën Maglum 800/ ose ekuivalent i tij”, me fond limit 8,532,900.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 20.06.2023 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 27.06.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3209 dhe me nr. 1484/2023 prot., datë 27.06.2023 e operatorit ekonomik “Genius” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit si dhe kundërshtohet kualifikimi i operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK në këtë procedurë.

III.1.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1484/2 date 29.06.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Genius” SHPK për të cilat ngrihen pretendime dhe kriteret, të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Me datë 30.06.2023 operatori ekonomik ankimues “Genius” SHPK ka paraqitur të njëjtën ankesë në formë shkresore në KPP e cila u protokollua me tonën me nr. 1484/3 prot.

III.1.6. Me shkresën nr. 470 prot, datë 29.06.2023 me objekt: “Njoftim në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Genius” protokolluar me tonën me nr. 1484/4 datë 30.06.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Genius” SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor ky i fundit ka argumentuar se: “Nga ana e Komisionit te

Vleresimit te Ofertave eshte bere klasifikimi paraprak dhe jane njoftuar nepermjet sistemit te APP-se operatoret ekonomik te renditur te pare te paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve nr.1 me adresë: Rr. "Vllazen Huta", Tiranë, dokumentet provuese për vetdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentat e paraqitura në rrugë elektronike si dhe listen e dokumentacionit te paraqitur.

Pra, nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk eshte bere akoma njoftimi i fituesit paraprak nepermjet sistemit elektronik."

III.1.7. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe nga informacioni i autoritetit kontraktor (paraqitur në KPP përmes shkresës me nr. 470 prot., datë 29.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1484/4 prot., datë 30.06.2023) Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga ana e autoriteti kontraktor akoma nuk është publikuar njoftimi i fituesit paraprak/njoftimi i anulimit në SPE.

III.1.8. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 "Afatet për ankimim" të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se: "2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik."

III.1.9. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik."

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se: "1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik."

III.1.10. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është **7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.**

Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor (përmes shkresës me nr. 470 prot., datë 29.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1484/4 prot., datë 30.06.2023) rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është publikuar njoftimi i fituesit paraprak apo njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. KPP vëren, se operatori ekonomik “Genius” SHPK me datë 27.06.2023 përmes sistemit elektronik të ankesave ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe me datë 30.06.2023 në formë shkresore ka paraqitur pranë KPP-së ankesën me nr. 1484/4 prot., ku kërkon kualifikimin e tij dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, ndërkohë nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton se akoma nuk është publikuar në sistem njoftimi i fituesit paraprak apo anulimi i procedurës, moment procedural nga i cili fillon afati i ankimimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”,

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk ka filluar ende, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik me datë 27.06.2023 përmes sistemit elektronik të ankesave, si dhe me datë 30.06.2023 në Komisionin e Prokurimit Publik, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesat e dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, nuk kanë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesave nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesat e operatorit ekonomik “Genius” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71354-06-01-2023 me objekt “Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi për laboratorin për aparatën Maglum 800/ose ekuivalent i tij”, me fond limit 8,532,900.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Genius” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

